

Veprat e zemrës

Hoxhë Lulzim Perçuku

Varg ligjëratash të ligjëruara në vitin 2022, te Qendra “Udhëzimi”.

Transkriptimet: Albiona Olluri

Pozita e veprave të zemrës

Veprat e zemrës kanë pozitë të lartë dhe nivel të ngritur tek Allahu. Për këtë janë disa arsye:

» *Veprat e zemrës janë prej besimit.* Besimi ka pjesën e jashtme (veprat e gjymtyrëve) dhe pjesën e brendshme (veprat e zemrës). Pjesa e jashtme nuk bën dobi nëse nuk e ka pjesën e brendshme të tij.

» *Veprat e zemrës janë shpirti dhe thelbi i adhurimeve tona që i kryejmë me gjymtyrët tona të jashtme.* Nëse veprave të gjymtyrëve u mungojnë veprat e zemrës, atëherë ato janë sikurse trupi pa shpirt.

» *Veprat e zemrës janë baza e Islamit.*

» *Veprat e zemrës janë origjina e devotshmërisë.*

Ti dish dhe të mësosh rëndësinë e veprave të zemrës, t'ua kujtosh të tjerëve dhe t'i zbatosh në jetën e përditshme, kjo është dritë mbi dritë.

Rëndësia e veprave të zemrës në jetën e muslimanit

Allahu, të gjithë njerëzit, i ka krijuar për një qëllim shumë madhështor, që është: adhurimi ndaj Allahut të Vetëm, duke mos i shoqëruar asgjë në adhurim, **“Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë.”** Dharijat 56.

Shejhul Islam ibën Tejmije kur e definoi (përkufizon) adhurimin thotë: *“Adhurimi është emër që përfshin të gjitha ato gjëra të cilat Allahu i do dhe me të cilat është i kënaqur, që janë fjalët e brendshme (të zemrës) dhe të jashtme (të gjuhës), veprat e brendshme dhe të jashtme, si: namazi zekati, agjërimi, haxhi etj., dhe gjithashtu dashuria ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij, frika ndaj Allahut e bazuar në dije (khashje), kthimi tek Ai me synimet tona dhe me pendim etj.”*

Adhurimi ndahet në dy lloje:

1. Fjalë dhe vepra të jashtme, këto quhen vepra të gjymtyrëve.
2. Fjalë dhe vepra të brendshme, që janë të zemrës.

Sa i përket rëndësisë së veprave të zemrës, së pari themi se adhurimi ka dy anë: anën e brendshme dhe të jashtme, që të dyja janë shkak për të arritur shpërblime tek Allahu. Nëse njeriu tregohet i mangët dhe neglizhent në njërin prej tyre, atëherë edhe adhurimi i tij është i mangët (nuk merr shpërblim të plotë). Madje, në disa raste, mangësia në veprat e zemrës e mangëson shpërblimin më shumë, sepse siç kemi thënë adhurimet e zemrës janë baza (origjina) dhe se obligimet e veprave të zemrës janë shumë më të mëdha se ato të gjymtyrëve. Ibën Kajimi rahimehullah ka thënë: *“Obligimet e zemrës janë shumë më të mëdha e më të forta sesa ato të gjymtyrëve dhe janë më të konfirmuara. Shumica e njerëzve mendojnë se ato nuk janë prej obligimeve të fesë. Ata mendojnë se thjesht janë vepra të mira e të pëlqyera.”*

Pastaj themi se:

» Njeriu do të merret në llogari në Ditën e Gjykimit dhe do të shpërblehet apo të dënohet për veprat e zemrës ashtu si për veprat e jashtme. Allahut thotë: **“Vallë, a nuk e di ai se kur të nxirren jashtë ata që gjenden në varre dhe, kur të dalë në shesh ajo që është në gjokse...”** Adijat 9-10.

» Veprat e zemrës janë baza, kurse adhurimet e gjymtyrëve i pasojnë dhe i plotësojnë ato. Veprat e zemrës janë më të konfirmuara dhe më të përforcuara, pa i nënvlerësuar aspak adhurimet e jashtme, sepse ka prej tyre të cilat nëse braktisën del prej fesë (siç mendojnë disa prej dijetarëve për braktisjen e namazit), apo ka prej tyre me të cilat përmirësohet gjendja e umetit (siç është urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja, thirrja në rrugën e Allahut e të tjera).

» Dallimi në vlerë i veprave të jashtme që bëjnë muslimanët është në varësi të dallimit të tyre në veprat e brendshme. Pra, muslimanët dallojnë në shpërblimin që marrin dhe në vlerën e veprave të tyre jashtme, varësisht se si i kanë veprat e brendshme. Ibën Tejmije rahimehullah ka thënë: *“Veprat e jashtme dallojnë në vlerë të personi varësisht dallimit të veprave të tij të brendshme, si: besimi, sinqeriteti etj. Për këtë gjen se janë dy persona të cilët falen në një rresht, afër njëri-tjetrit, mirëpo dallimi mes namazit të tyre është si dallimi mes qiellit e tokës (në varësi të asaj se çfarë kanë në zemra).”*

» Zemra është vendi ku Allahu shikon. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Vërtet, Allahu nuk shikon pamjet dhe pasurinë tuaj, por shikon zemrat dhe veprat tuaja.”** Muslimi. Këtu përmend së pari zemrën (adhurimet e saj), para veprave.

» Me përmirësimin e zemrave tona, përmirësohen gjymtyrët tona (veprat). Nëse zemra prishet, prishen edhe veprat tona të jashtme. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Në trup është një copë**

mishi e cila nëse përmirësohet, atëherë përmirësohet i gjithë trupi dhe nëse ajo prishet, atëherë prishet i gjithë trupi. Ajo është zemra.”

» Kënaqësia dhe prehja në adhurime nuk mund të arrihet përveçse atëherë kur njeriu arrin të realizojë veprat e zemrës. Kushdo që synon të përjetojë kënaqësinë e adhurimeve, atëherë le të përpiqet siç janë përpjekur besimtarët të cilët punojnë shumë dhe janë të parët në vepra të mira, së pari duke i përmirësuar veprat e zemrës.

Shkaqet që ndihmojnë në realizimin e adhurimeve të zemrës

- » Shtimi i lutjeve tek Allahu për të ta mundësuar t'i realizosh veprat e zemrës, në çdo kohë, sidomos kohët kur pranohen më shumë lutjet.
- » Boshatisja dhe dëlirja e zemrës prej sëmundjeve të saj, si: mendjemadhësia, zilia, syfaqësia, vetëpëlqimi, dashuria ndaj epsheve dhe mëkateve etj. Gjithashtu ndalja prej gjynaheve që kryhen me gjymtyrë. Në këtë mënyrë pastaj zemra është e përgatitur dhe e gatshme të pranojë veprat e zemrës (të mbushet me to).
- » Kujtimi i adhurimeve të zemrës para fillimit të veprimit të një vepre të jashtme. Shembull: Para namazit të kujtosh gjërat që sjellin përrulje dhe nënshtrim gjatë faljes.
- » Dëgjimi i ligjëratave/mësimeve të hoxhallarëve që flasin për veprat e zemrës.
- » Leximi i librave që flasin për veprat e zemrës.
- » Edukimi qysh në fëmijëri për veprat e zemrës në mënyrë që fëmija pastaj të rritet me to dhe ta shoqërojë gjithmonë. Ashtu siç ua mëson fëmijëve veprat e gjymtyrëve, ashtu duhet t'ua mëson edhe veprat e zemrës (gradualisht, aq sa percepton fëmija, në varësi të aftësisë dhe moshës që ka), si: madhërimi ndaj Allahut, dashuria ndaj Tij, shpresa dhe frika ndaj Tij, mbështetja tek Ai etj. Shembull: Kur prindi ia mëson fëmijës mënyrën e faljes së namazit dhe obligueshmërinë e tij, duhet t'ia mësojë edhe përruljen gjatë faljes dhe shkaqet e kësaj dhe se namazi duhet të falet me sinqeritet (me ikhlas). Kur prindi ia mëson fëmijës leximin dhe memorizimin e Kuranit, duhet t'ia mësojë rëndësinë e leximit me meditim.

» Shoqërimi me njerëz të devotshëm, me besimtarë të mirë. Vetëm hedhja e shikimit tek ta dhe ulja me ta, e bën njeriun ta kujtojë Allahun, botën tjetër, xhenetin dhe xhehenemin etj.

Këto ishin shtatë shkaqe të cilat nëse ne i veprojmë atëherë me lejen e Allahut, do të përmirësohet gjendja e adhurimeve dhe veprave tona të zemrës.

Disa prej veprave të zemrës

Pendimi

Pendimi (teube) është një prej adhurimeve më madhështore të zemrës. Këtë adhurim do ta trajtojmë përmes ngjarjes së Kab ibn Malikut, e cila ka ndodhur në kohën e Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem. Kabi nuk kishte marrë pjesë në betejën e Tebukut, duke mbetur në Medine, edhe pse shpirti e ka nxitur për t'iu bashkëngjitur Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem dhe shokëve të tij. Pastaj është pikëlluar dhe penduar shumë për këtë mëkat që kishte bërë. Andaj vendos të shkojë te Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem dhe të shfaqë pendimin e tij, e jo të bënte sikur hipokritët të cilët gjenin justifikime të ndryshme por që realisht ishin gënjeshtarë në ato justifikime (sepse arsyeja pse nuk kishin marrë pjesë ishte hipokrizia në zemrat e tyre).

Të lexojmë dialogun mes Kabit dhe Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem, transmetuar te Buhariu dhe Muslimi. Kabi tregon:

*“Kur erdhi Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem prej beteje, unë shkova tek ai dhe i dhashë selam. Ai buzëqeshi por me buzëqeshje të atij që është i zemëruar/hidhëruar me tjetrin. Më tha: **“Eja!”** Dhe vazhdova të eci derisa u ula para tij. Më pyeti: **“Cila është arsyeja që mbete mbrapa dhe nuk na bashkove në betejë? A nuk është e vërtetë se ti kishe një kafshë me të cilën do të mundje të vije të na bashkëngjiteshe në betejë?”** I thash: *“Gjithsesi. Unë kam pasur me çka të vija, por pasha Allahun u ula tek ti dhe nëse do të isha ulur te ndonjë tjetër njeri prej banorëve të tokës, do të gjeja justifikime për ta nxjerr veten sepse unë kam forcë të debatoj, mirëpo Allahu e di dhe unë e di se nëse sot të gënjej dhe të justifikohem rrejtshëm dhe ndahesh pastaj i kënaqur prej meje, atëherë kam frikë se shumë shpejt Allahu do të jetë i zemëruar me mua dhe do të më ndëshkojë për gënjeshtren. Unë e di që nëse të flas me të vërtetën, atëherë shpresoj me këtë të fitoj faljen e Allahut. Dhe pasha Allahun, nuk kam pasur ndonjë arsye (fetare) që më ka ndalur të të mos bashkëngjitëm në betejë. Nuk kam qenë ndonjëherë më i fortë dhe më i fuqishëm**

për të udhëtuar sesa kësaj here, por kam mbetur mbrapa nga neglizhenca etj.”
Atëherë Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem tha: “Ky e tha të vërtetën.
Ngrihu dhe shko derisa të gjykojë Allahu për ty.” Dhe u largova.”

Prej këtij momenti, veçse ka filluar sprova për Kab ibn Malikun radijAllahu anhu. Ai ka pasur situata e pengesa aq të mëdha sa gati nuk e kanë dobësuar vendosmërinë e tij në këtë pendim të sinqertë që ka bërë. Mirëpo, pendimi i sinqertë dhe i vërtetë dhe qëndrueshmëria në këtë rrugë, pas suksesit dhe inspimit që ia ka dhënë Allahu, kanë bërë që ai t’i tejkalojë pengesat si një trim dhe hero sa herë që është ballafaquar me to.

Të përmendim disa prej këtyre situatave dhe pengesave:

» Përderisa Kabi ka qenë në pritje të gjykimit të Allahut, i kanë ardhur disa kushërinj prej fisit Beni Seleme duke i thënë: “Pse nuk shkon te Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem të arsyetohesh sikur hipokritët dhe pastaj ai të kërkojë falje për ty dhe Allahu të të falë?” Kanë vazhduar ta qortojnë dhe ta nxisin gati sa nuk e ka bërë, por Allahu e ka forcuar të qëndrojë përballë kësaj sprove.

» Bojkotimi prej muslimanëve. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem i ka ndaluar muslimanët në Medine që t’iu flasin tre personave që nuk kanë marrë pjesë në betejë, njëri prej të cilëve ka qenë edhe Kabi. Kështu njerëzit janë larguar prej tyre dhe kanë ndryshuar qëndrimin për ta saqë toka iu është dukur ndryshe- e panjohur. Kjo ka zgjatur për 50 ditë radhazi.

» Bojkotimi prej shokut të dashur. Kabi ka kaluar fshehurazi murin e kopshtit të Ebu Katades i cili ishte djali i xhaxhait të tij dhe njeriu të cilin ai e ka dashur së shumti. Ai i ka dhënë selam, por ebu Katade nuk ia ka kthyer. I ka thënë: “O Ebu Katade, të betohem në Allahun! A e di ti se unë e dua Allahun dhe të Dërguarin e tij?!” Mirëpo, ai ka heshtur. Kabi ia ka përsëritur dhe ai ka heshtur, dhe pasi i ka thënë për të tretën

herë, Ebu Katade ia ka kthyer: *“Allahu dhe i Dërguari i tij e dinë më mirë!”*
Kur e ka dëgjuar këtë i kanë rrjedh lot dhe është larguar.

» Ftesa e mbretit. Kur mbreti i Gasasinëve, një fis arab i krishterë, ka dëgjuar për ngjarjen e Kabit atëherë ia ka shkruar një letër mesazhi duke i thënë: *“Më ka arritur lajmi se shoku yt (Muhamedi salAllahu alejhi ue selem) i ka ftohur raportet me ty. Por, Zoti nuk të lejon të qëndrosh në një vend ku je i poshtëruar dhe i nënçmuar. Andaj, bashkohu me neve, se ne të përkrahim!”* Kur e ka lexuar letrën Kabi, ka thënë: *“Edhe ky është një provim prej Allahut (se a jam i sinqertë)!”* Andaj, e ka marrë letrën dhe e ka nderur zjarrin me të.

» Largimi prej bashkëshortes. Kur kanë kaluar 40 ditë (prej 50 ditëve) atëherë Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem e ka dërguar dikë te Kabi që t’i thotë: ***“Largohu prej bashkëshortes!”*** Edhe kjo një sprovë shumë e madhe. Pastaj Kabi i ka thënë asaj të shkojë te familja e saj të qëndrojë me ta derisa Allahu të gjykojë për çështjen e tij.

Dhe kur janë plotësuar 50 ditë, Allahu ka zbritur ajetin 118 të sures Teube me të cilin ka treguar se ia ka pranuar pendimin Kabit: ***“Ai ua pranoi pendimin edhe atyre të treve, që mbetën mbrapa atëherë, kur toka, sado e gjerë, iu duk e ngushtë dhe iu shtrënguan shpirtat, aq sa u bindën se nuk ka strehim tjetër përveç Allahut e pastaj Allahu u dha mëshirë që të pendohen. Me të vërtetë, Allahu pranon pendimin dhe është Mëshirëplotë.”***

Pasi ka zbritur ky ajet, Kabi ka shkuar te Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem fytyra e të cilit ka shkëlqyer prej gëzimit dhe i ka thënë: ***“Përgëzohu për ditën më të mirë në jetën tënde, prej që të ka lindur nëna!”***

Andaj, kjo ngjarje na mëson se *pendimi është prej veprave më të mira e më të vlefshme të zemrës.*

Kuptimet e pendimit

Pendimi me të cilin jemi urdhëruar përfshin disa kuptime dhe domethënie:

» Pendimi për gjynahet, të vogla dhe të mëdha, të bëra fshehurazi apo haptazi.

» Pendimi për mangësinë gjatë adhurimeve (duke mos u kryer në formën e kërkuar). Andaj, është ligjësuar të themi estagfirullah (tre herë) menjëherë pas namazit farz, apo pas namazit të natës në kohën e syfyrit, apo pas kryerjes së haxhit etj.

» Pendimi për mangësinë në falënderimin ndaj Allahut (duke mos qenë falënderues siç duhet për të mirat e Allahut në fe dhe dunja etj.).

» Pendimi për mangësinë në madhërimin dhe lavdërimin ndaj Allahut (duke mos e bërë ashtu siç e meriton Allahu).

» Pendimi për mosveprimin e gjërave që janë të pëlqyera dhe për veprimin e gjërave që janë të papëlqyera.

Pozita e lartë e pendimit

Prej gjërave të cilat tregojnë për pozitën e lartë të pendimit janë:

▪ *Allahu gëzohet kur robi i Tij pendohet.* Dhe kur Allahu gëzohet për një gjë, kjo tregon se ajo është madhështore dhe e rëndësishme.

▪ *Allahu i do ata që pendohen.* Dhe kur Allahu e do robin e Tij, mos pyet se sa mëshira prej Tij zbresin mbi të, sa bekime e përfshijnë atë, sa lumturi e qetësi e prekin zemrën e shpirtin e tij dhe sa mbrojtje e ruajtje prej Allahut e rrethojnë atë.

▪ *Pendimi është kulmi i përsosjes së besimtarit.* Ibën Tejmije rahimehullah ka thënë: *“Kulmi të cilin e synon çdo besimtar në arritjen e plotësueshmërisë/përsosjes së tij, është pendimi tek Allahu.”*

▪ *Dita në të cilën pendohet besimtari është dita më e mirë e jetës së tij.* Ibën Kajimi rahimehullah kur flet për ngjarjen e pendimit të Kab ibn Malikut thotë: *“Në të ka argument se dita më e mirë për besimtarin është dita kur ai pendohet dhe Allahu ia pranon atë. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem i tha Kabit: **“Përgëzohu për ditën më të mirë në jetën tënde, prej që të ka lindur nëna!”** Nëse dikush pyet: “Si ka mundësi që kjo ditë të jetë më e mirë sesa dita kur njeriu hyn në Islam?”, atëherë themi: “Dita kur Kabi dhe shokët e tij janë penduar dhe Allahu ua ka pranuar atë, kjo ka qenë plotësim/përsosje e ditës së hyrjes në Islam. Për këtë, dita e pranimit të Islamit është dita e fillimit të lumturisë, ndërsa dita e pendimit është plotësimi i saj (lumturisë).”*

▪ Pendimi i sinqertë është rruga për arritjen e shpëtimit, shlyerjes së mëkateve dhe fitimit të xhenetit. Allahu thotë: **“O ju, që keni besuar! Kthehuni tek Allahu me një pendim të sinqertë, që Zoti juaj t’ju shlyejë gabimet e t’ju shpjerë në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj...”** Tahrim 8. Dhe: **“Të gjithë ju, o besimtarë, kthehuni tek Allahu të penduar, që të arrini shpëtimin!”** Nur 31. Dijetari Sadi rahimehullah kur komenton këtë ajet thotë: *“Nuk ka rrugë përmes së cilës njeriu arrin shpëtimin, veçse përmes rrugës së pendimit. Pendim është të largohesh prej gjërave që nuk i do Allahu, me të brendshmen dhe me të jashtmen, e të drejtohesh për tek ato gjëra të cilat Ai i do, me të brendshmen dhe të jashtmen tënde. Ky ajet tregon se çdo besimtar është nevojtar të pendohet tek Allah dhe nxit të pendohemi sinqerisht (për Allahun).”¹*

▪ *Pendimi është shkak për shlyerjen e mëkateve.* Ato e mbulojnë zemrën e besimtarit, janë barrë mbi kurrizin e tij, ato e pengojnë të mos përrjetojë kënaqësinë gjatë adhurimeve, ato janë shkak të mos ndjejë hare, gëzim e lumturi kur i afrohet Allahut me adhurime të ndryshme, ato prangosin zemrën dhe gjymtyrët e tij për të mos shpejtuar drejt Atij dhe

¹ Jo për syfaqësi, që të tjerët ta lavdërojnë se është penduar, jo të pendohet që të shpëtojë prej dënimit në këtë botë etj.

kënaqësisë së Tij. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Kur njeriu vepron një mëkat, në zemrën e tij vendoset një pikë e zezë, por nëse heq dorë, pendohet dhe kërkon falje tek Allahu, i pastrohet. Nëse vazhdon në mëkate, i shtohen pikat e zeza, derisa t’ia mbulojnë zemrën. Kjo është mbulesa e përmendur në ajetin: “...veprat e tyre (të këqija) ua kanë mbuluar zemrat.”** Mutaffifinë 14. Ibën Kajimi kur përmend disa prej dënimeve të Allahut që vijnë si pasojë e mëkateve, thotë: *“Prej pasojave të mëkateve është mbulimi i zemrës mes njeriut dhe Zotit, e mbulesa më e madhe është në botën tjetër, “Në të vërtetë, atë ditë një vel do t’i pengojë ata që të shohin Zotin e tyre, pastaj, me siguri, do të hyjnë në Zjarrin e Xhehenemit...”* Mutaffifinë 15-16. *Mëkatet i bëhen pengesë njeriut të mos arrijë as te zemra e tij dhe të shohë se çfarë e përmirëson, e pastron dhe e prish atë dhe si të ketë jetë të mirë. Më e rëndë sesa kjo është se e pengojnë të kalojë rrugën prej zemrës deri te Zoti, e kur zemra shkon tek Ai fiton afërsinë e Tij, nderimin e Tij, kënaqet me Atë dhe gjen prehje. Kështu, mëkatet bëhen pengesë mes vetë personit dhe zemrës së tij dhe mes zemrës së tij dhe Krijuesit.”*

Pengesat që vijnë prej bërjes së mëkateve janë:

-Pengesat e mëkateve të jashtme.

-Pengesat e mëkateve të brendshme. Ky lloj është më i rrezikshëm se lloji i parë, kjo sepse shumë të fshehta, personi nuk i vëren dhe i bëhen pjesë e tij, personi nuk i pranon por arsyetohet duke i quajtur me emra të tjerë (vetëpëlqimin e quan përgëzim të përshpejtuar, xhelozinë ndaj të tjerëve e quan xhelozinë ndaj fesë, zilinë ndaj të tjerëve e quan garim në punë të mira, mendjemadhësinë e quan krenari etj.), lëshojnë rrënjë në zemër dhe i ndezin mëkatet e jashtme (të gjymtyrëve) etj.

▪ Përmes pendimit largohen sprovat, fatkeqësitë, dëmet, luftërat, brengat, sëmundjet, çmimet e larta etj. Pendimi bëhet shkak për mbrojtjen prej tyre para goditjes me to, apo për largimin e tyre pasi goditjes me to. Allahu thotë: **“Përse nuk pati ndonjë qytet, banorët e të cilit të besonin e t’u bënte dobi besimi i tyre, përveç popullit të Junusit? Kur ata besuan, Ne ua larguam dënimin e poshtërimin në jetën e kësaj bote dhe i lamë të kënaqeshin edhe njëfarë kohe.”** Junus 98. Ibën Kethiri duke komentuar këtë ajet thotë: *“Populli i Junusit (kur kanë parë shenjat e dënimit të Allahut pasi nuk i janë bindur Junusit) janë tubuar në një vend (me fëmijë, me kafshë etj.) dhe janë lutur, duke shfaqur përulje e nënshtrim ndaj Allahut, atëherë Ai i ka mëshiruar dhe u ka dhënë afat të jetojnë edhe për një kohë.”*

Kushtet e pendimit:

-Kushtet në raport me Allahun: Të heqësh dorë prej mëkateve, pendimi (keqardhja shpirtërore) dhe vendosmëria për të mos iu kthyer mëkateve.

-Kushtet në raport me njerëzit: Të kthehet e drejta që i takon tjetrit, si: në pasuri (ta kthejë pasurinë e marrë), në nderë (t’i kërkojë falje) etj.).

-Pendimi të bëhet në afat: Para se të vijë shpirti në fyt dhe para se të lindë dielli prej perëndimit.

Sinqeriteti (ikhlas) në adhurimet tona

Sinqeriteti është prej veprave më madhështore dhe më të rëndësishme të zemrës. Madje, ai llogaritet të jetë baza dhe shtylla, përmes së cilës njeriu përmirëson brendësinë e tij, sepse të gjitha adhurimet e zemrës kthehen te sinqeriteti.

Dijetarët kanë thënë: *“Sinqeriteti është veçimi i Allahut në synimet e qëllimet e tua kur kryen adhurime ndaj Tij.”* Disa kanë thënë: *“Sinqeriteti është të mos kërkosh për veprën tënde ndonjë dëshmitar apo shpërblyes përveçse Allahun.”* Një prej dijetarëve të selefit ka thënë: *“Sinqeriteti është kur te njeriu veprat e jashtme dhe të brendshme janë njësoj.”*

Rëndësia e sinqeritetit:

» Sinqeriteti dhe pasimi i Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem janë dy kushtet e pranimit të veprës.

» Veprat dallojnë në vlerë dhe shpërblim në bazë të sinqeritetit në to.

» Sinqeriteti shumëfishon shpërblimin e veprave tona edhe janë shumë të vogla.

» Sinqeriteti e mbron zemrën prej epsheve dhe dyshimeve dhe për largimin e tyre.

» Sinqeriteti në vepra bëhet shkak të të shlyhen mëkatet e mëdha (edhe nëse ajo vepër është e vogël) dhe të hysh në xhenet.

Kush dëshiron që Allahu t’ia ruajë zemrën dhe t’ia shërojë atë prej sëmundjeve të epsheve dhe dyshimeve, sidomos sot, atëherë le të mundohet të realizojë sa më shumë sinqeritetin në zemrën e tij.

Vërtetësia (sidku)

Pejgamberi salallahu alejhi ue selem ka thënë: **“Përmbajuni vërtetësisë dhe mos iu ndani asaj, ngase ajo të çon te devotshmëria dhe devotshmëria çon në xhenet. Njeriu vazhdimisht është i vërtetë në atë që e thotë/vepron derisa të shkruhet es siddik tek Allahu.”** Dhe ka thënë: **“Kini kujdes prej gënjeshtërs sepse ajo të çon në mëkate dhe kjo pastaj çon në zjarr. Njeriu vazhdimisht do të gënjejë derisa të shkruhet gënjeshtar i madh.”**

Ne duhet ta lusim Allahun të na bëjë prej të sinqertëve dhe të vërtetëve, sepse kjo pozitë (es siddikije) vjen pas pozitës së Pejgamberisë. Allahu thotë: **“Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit, do të jetë me ata të cilëve Allahu u ka dhënë shumë dhunti: me profetët, me të sinqertët, me dëshmorët dhe me të drejtët! Eh sa shokë të mrekullueshëm janë këta!”** Nisa 69.

Vërtetësia përfshin fjalët, veprat dhe zemrën. Allahu thotë: **“Ata, që e shpallin të Vërtetën dhe që i besojnë asaj, pikërisht ata janë të përkushtuarit që i frikësohen Zotit.”** Zumer 33. Ibën Kajimi thotë: *“Ai që e sjell të vërtetën, është ai gjendja/çështja e të cilit e gjitha ka të bëjë me të vërtetën (në fjalë, në vepra dhe në zemër). Nga kjo kuptojmë se vërtetësia përbën tri lloje:*

1. *Vërtetësia në fjalë (gjuha flet fjalë të ligjshme).*
2. *Vërtetësia në vepra (të drejta e të bazuara në ligjet e fesë).*
3. *Vërtetësia në gjendje (veprat e zemrës dhe të gjymtyrëve të qëndrojnë mbi sinqeritetin- ihlasin).*

Varësisht se sa njeriu i plotëson këtë lloje të vërtetësisë dhe i zbaton ato, po aq do të arrijë nivelin e vërtetësisë tek Allahu. Për këtë, Ebu Bekri e ka arritur kulmin e këtij niveli (është quajtur es Siddik në mesin e sahabëve).”

Vërtetësia është prej veprave më madhështore zë zemrës dhe është shpirti i adhurimeve tona, madje ajo është peshorja e gjendjeve tona. Përmes saj dallohen dyfytyrëshit prej besimtarëve. Çdokush i cili është i vërtetë me Allahun, në zemër, fjalë dhe vepra, edhe Allahu do të jetë i vërtetë në realizimin e asaj që ai dëshiron apo në shpërblimin që do t'i japë. Allahu do t'i japë prej dhuntive e mirësive të Tij dhe do t'i japë suksese. Allahu do të jetë me ata që janë të vërtetë. Sa më shumë që je i vërtetë e i sinqertë me Allahun, aq më shumë Ai do të jetë me ty.

Do të përmendim katër raste të vërtetësisë ndaj Allahut:

- *Ibrahimi alejhisselam*. Ai ka thyer idhujt me duart e tij dhe populli ka vendosur të hakmerret ndaj kësaj, andaj e kanë ndezur një zjarr të madh për ta djegur, e Ibrahim, duke e hedhur në zjarr, ka thënë: “HasbunAllahu we nimel we kil – Na mjafton Allahu, sa mbrojtës i mirë është Ai!” Allahu thotë: **“Ne thamë: “O zjarr, bëhu i ftohtë dhe shpëtim për Ibrahimin!”** Enbija 69. Allahu ia ka hequr zjarrin cilësinë e djegies dhe në këtë mënyrë ai nuk e ka djegur Ibrahimin.

Ibrahimi ka qenë i sinqertë në këtë lutje që ka bërë, në mbështetjen tek Ai dhe në kërkimin e ndihmës dhe strehës tek Ai, dhe Allahu ishte i vërtetë me të, iu përgjigj lutjes dhe e ndihmoi prej kësaj të keqeje. Allahu është mbrojtësi dhe ndihmëtar i mirë.

- *Esved el Anesi*, i cili ka pretenduar se është Pejgamber. Ai ka qenë prej banorëve të Jemenit. Kjo gjë ka ndodhur në kohën e Muhamedit salAllahu alejhi ue selem. Ai i ka thënë Ebu Muslim el Haulanit: “A dëshmon se unë jam Pejgamber?” Ndërsa ky i ka thënë me sinqeritet e vërtetësi: “Unë dëshmoj se vetëm Muhamedi salAllahu alejhi ue selem është i Dërguar i Allahut.” Pastaj ai e ka ndezur një zjarr të madh dhe e ka hedhur Ebu Muslim el Haulanin, mirëpo zjarri nuk e ka prekur, atë e ka ruajtur Allahu. Ai (nga kjo gjë) gjithmonë është përngjasuar me Ibrahimin alejhisselam. Pas kësaj ka bërë hixhret në Medine dhe ka

parë se Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka vdekur, pastaj ka shkuar tek Ebu Bekri (khalifja) radijAllahu anhu i cili e ka ulur pranë vetës ndërmjet tij dhe Umerit dhe ai e ka treguar ngjarjen e tij. Umeri pastaj ka thënë: *“Falënderimi i takon Allahut i Cili nuk ma mori shpirtin derisa pash se në umetin e Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem paska njerëz të tillë me të cilët Allahu ka vepruar siç ka vepruar me Ibrahimin alejhisselam!”* Dhe e ka puthur në ballë Ebu Muslim el Haulanin.

- *Musai alejhisselam.* Pasi Faraoni ia ka lejuar të largohet prej Egjiptit bashkë me popullin e vet, është penduar dhe i ka ndjekur për t’i mbytur, derisa janë afruar te Deti i Kuq, duke mos pasur zgjidhje përpara, ndërkohë që Faraoni me ushtri ishin pas tyre. Allahu na tregon në Kuran: **“Kur dy grupet panë njëri-tjetrin, shokët e Musait thirrën: “Me të vërtetë, na zunë!”** Shuara 61. Mirëpo, Musai zemra e të cilit ishte e mbushur me tewekul dhe bindje të singertë në fitoren prej Allahut, tha: **“Kurrsesi! Në të vërtetë, me mua është Zoti im. Ai do të ma tregojë rrugën”.** Dhe Ne i shpallëm Musait: **“Bjeri me shkopin tënd detit!”** Menjëherë deti u nda dhe çdo pjesë e tij u bë si **mal i madh.**” Shuara 62-63. Dhe Allahu i shpëtoi.

- *Ala el Hadrami (tabiin).* Ai ka shkuar me ushtri të çlirojë një prej ishujve në Gadishullin arabik, mirëpo nuk kanë pasur anije për t’i bartur deri aty. Dhe ka filluar ta lusë Allahun: *“O Allah, na bëj/hap një rrugë që të mbërrijmë deri tek armiqtë!”* Dhe kështu ecën mbi sipërfaqen e ujit deri tek ishulli.

Shejhul islam ibën Tejmije: *“Sa herë që njeriu është i vërtetë me Allahun, Ai do të veprojë me të ashtu siç ai e ka mendimin e mirë ndaj Tij. Prandaj, kush është i vërtetë e i singertë në adhurimin ndaj Allahut, atij do t’i vijnë mirësitë e Tij dhe do ta afrojnë afër Vetës. Kush është i vërtetë e i singertë në lutjen e tij, Allahu do t’ia japë atë që shpreson. Kush është i vërtetë e i singertë në pendimin e tij, Allahu do t’ia falë gjynahet dhe do t’ia pranojë pendimin. Kush është i vërtetë e i singertë në kërkimin e mbrojtjes tek Allahu, Ai do t’ia*

lehtësojë gjendjen dhe do ta ndihmojë. Kush është i vërtetë e i sinqertë në qëllimet e tij, Allahu do t'i japë shpërblime të mëdha edhe nëse nuk ka mundësi ta kryejë veprën (që e ka pasur qëllim)."

Dallimi mes ihlasit dhe sidkit

» Baza është sidku, pastaj ihlasi është degë e tij, që e ndjek atë. Besimtari nëse është i vërtetë me Allahun, patjetër se do t'i bëjë veprat sinqerisht për Allahun – të pastra vetëm për Atë.

» Ihlasi kërkohet kur njeriu fillon adhurimin/veprën, ndërsa sidku është para veprës.

» Ihlasi zakonisht vjen karshi shirkut dhe kufrit. Besimtari e adhuron Allahun me ihlas – me sinqeritet, ia dedikon adhurimet vetëm Atij, ndërsa të tjerët i bëjnë shirk – i shoqërojnë të tjerë në adhurim. Allahu thotë: **"...lutjuni Allahut me adhurim të sinqertë për Të, edhe nëse këtë e urrejnë jobesimtarët!"** Gafir 14. Ndërsa, sidku vjen karshi hipokrizisë. Hipokritët besojnë rrejshëm: në zemër e fshehin mohimin, kurse jashtë e shfaqin Islamin. Allahu thotë: **"Nuk ka dyshim se Allahu do t'i shpërblejë të vërtetët për vërtetësinë e tyre e do t'i dënojë hipokritët, nëse do ose do t'u pranojë pendimin."** Ahzab 24.

Mendimi i mirë ndaj Allahut

Këtë çështje do ta trajtojmë duke përmendur disa fragmente prej jetëshkrimit të Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem.

Ai salAllahu alejhi ue selem ka qenë ai i cili ka bart përgjegjësinë e thirrjes për tek Allahu për njëzetë e tre vite. Gjatë kësaj periudhe i kanë ndodhur shumë vështirësi dhe sprova të mëdha, si: përgënjeshtrimi prej idhujtarëve, lëndimet, torturat ndaj sahabëve, vdekja e Ebu Talibit i cili ka qenë krahë për të, pastaj vdekja e Khadixhes e cila ka qenë përkrahësja morale e tij, betejat e shumta, shpifja për nderin e Aishes etj.

Do të ndalemi vetëm te njëra, e cila ka qenë më e rënda gjatë këtij rrugëtimi të tij. Aisha radijAllahu anha ka treguar se e ka pyetur Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem:

“A ke përjetuar ditë më të vështirë sesa dita e betejës së Uhudit?”

Në këtë betejë janë vrarë shumë prej shokëve të Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem, ndërsa vetë ai është plagosur. Dhe është përgjigjur:

“Po. Dita kur jam lënduar prej popullit tënd (banorëve të Mekës) - dita e Akabesë.”

Në këtë ditë Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka shkuar në Taif për të thirrur drejtë fesë së Allahut. Dhe pasi ka treguar se i është refuzuar thirrja e tij dhe e kanë goditur me gurë, ka thënë:

“Jam kthyer (prej Taifit) i pikëlluar dhe i mërzitur, me kokë të ulur, saqë nuk jam kthjelluar derisa kam mbërrë në vendin Karnu Thealib.”

Do të ndalemi të meditojmë në këtë fjali të përmendur në fund, ku shohim se çfarë sprove e madhe ka përjetuar dhe çfarë pikëllimi i madh e ka kapluar atë. Pra, ai salAllahu alejhi ue selem është preokupuar aq

shumë me atë çështje saqë nuk i është larguar gjendja e vështirë derisa ka mbërritur në një vend, i cili sot i bie të jetë diku 55 km larg Taifit. Ai ka ecur në këmbë për caq kilometra dhe nuk është kthjelluar, edhe pse e dimë se ai ka qenë njeriu më i duruar, më shpresën të madhe tek Allahu, me zemrën e mendjen më të fortë, me personalitetin e karakterin e fortë dhe i fuqishëm shpirtërisht e moralisht.

Në Ditën e Akabesë janë bashkuar disa gjëra:

» *Refuzimi i thirrjes së tij në Taif.* Këtë gjë e ka përjetuar shumë rëndë, ngase Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka pasur zemër të pastër dhe ka dëshiruar që të tjerët t'i përgjigjen thirrjes së tij e të hyjnë në Islam (dhe të shpëtojnë). Allahu thotë në një ajet: **“A mos vallë ti (o Muhamed) do ta shkatërrosh veten, ngaqë ata (banorët e Mekës) nuk duan të besojnë?”** Shuara 3.

» *Arroganca që treguan njerëzit e Taifit.* Pasi Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem pa se Meka u shndërrua në një vend torturues për shokët e tij, atëherë deshi të shkojë në Taif (qytet afër Mekës) që banorët e tij të përqafojnë davetin e tij dhe ku shokët e tij do të gjejnë strehë dhe do të adhurojnë Allahun të sigurt prej ndëshkimeve. Mirëpo, këto shpresa shumë shpejt u shuan, për shkak të arrogancës që treguan njerëzit e Taifit, të cilët e refuzuan thirrjen, duke ngritur zërin dhe duke nxitur fëmijët, skllavet dhe të çmendurit që ta godisnin me gurë, derisa ia gjakosën këmbët.

» *Kthimi duke bartur brengën e davetit.* Pastaj u kthye në Meke duke bartur brengën e davetit, se kush do ta përkrahë thirrjen e tij, kush do t'i strehojë shokët e tij. Pasi mbërrin te vendi i cituar, atëherë i vjen Xhibrili alejhisselam. Vazhdon të tregojë:

“E ngrita kokën dhe pash se një re më bënte hije dhe mbi të ishte Xhibrili i cili më thirri në emër e më tha: “Allahu ka dëgjuar mirë se çfarë të ka thënë populli yt (që nuk iu përgjigjen thirrjes tënde).

Allahu ka dërguar tek ti engjëllin i cili është përgjegjës për kodrat dhe malet, që ti ta urdhërosh me çfarëdo që dëshiron të veprosh me banorët e Mekës dhe të Taifit.” Pastaj më thirri engjëlli i kodrave dhe maleve i cili më tha: “Nëse dëshiron, unë i bëj bashkë këto male (mes të cilave ka qenë Meka e Taifi) dhe i shkatërroj të gjithë banorët e tyre.”

Për një moment të vetëm, do të përfundonte ajo arrogancë dhe mendjemadhësi e idhujtarëve të Mekës, mirëpo Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem nuk e bërë atë gjë. Ai ka pasur mendim të mirë ndaj Allahut. Ai nuk e ka humbur kurrë shpresën në ndihmën, fitoren dhe mëshirën e Tij. Ai kurrë nuk e ka humbur shpresën për pranimin e udhëzimit të popullit të tij.

Këtu na sjell shembull të bukur se si besimtari duhet të ketë mendim të mirë ndaj Allahut, qoftë dhe në situatat më të rënda e më të vështira.

Dhe ka thënë:

“Shpresoj që Allahu të nxjerrë prej pasardhësve të tyre njerëz të cilët e adhurojnë Atë të Vetëm pa i bërë shok.”

Dhe pas pak vitesh, pas Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem në namaz, janë falur bijtë e kokave të armiqve më të mëdhenj të tij, si: Ikrime i biri i Ebu Xhehlit, Saufani i biri i Umejes, po ashtu dy djemtë e Ebu Lehebit dhe të tjerë. Baballarët e tyre ishin koka të mohimit, ndërsa bijtë u bënë prijës në Islam, përmes të cilëve Allahu çliroi zemrat dhe vendet e ndryshme të botës. Kush ka mendim të mirë ndaj Allahut, atëherë Ai i jep më shumë sesa që shpreson dhe dëshiron ai.

Mendimi i mirë ndaj Allahut është prej adhurimeve më madhore dhe më të rëndësishme, sepse buron prej dijes që personi ka për Allahun,

për Emrat, Cilësitë dhe Veprave të Tij. Sa më e shumtë që është kjo dije te personi, aq më shumë do të ketë mendim të mirë ndaj Allahut.

Kur ibën Kajimi flet për ajetin: **“Gjithashtu, (Ai e bëri këtë) për t’i ndëshkuar hipokritët dhe hipokritet, idhujtarët e idhujtaret, që mendojnë keq për Allahun”**, Feth 6, thotë: *“Mendojnë për Allahun diçka që nuk i shkon Madhërisë së Allahut dhe Emrave të përsosur të Tij.”*

Ibën Mesudi radijAllahu anhu ka thënë: *“Mëkatet më të mëdha janë: Shirku, ndjenja se je i sigurt prej dënimit të Allahut (edhe pse bën gjynahe), humbja e shpresës në Mëshirën e Allahut dhe humbja e shpresës/dëshpërimi në ndihmën e Tij.”*

Dijetari Iz ibën AbdiSelam ka thënë: *“Humbja e shpresës në Mëshirën e Allahut është kur e nënvlerëson dhe e sheh të paktë gjerësinë e madhe të mëshirës dhe faljes së Tij.”* Ky është një mëkat i madh. Allahu, këtë gjë e ka llogaritur prej tipareve të njerëzve të humbur, **“E kush mund ta humbë shpresën nga mëshira e Zotit të vet, përveç atyre që janë të humbur?!”** Hixhr 56. Dhe prej tipareve të jobesimtarëve, **“...mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut. Shpresën në mëshirën e Allahut nuk e humb askush, përveç jobesimtarëve”**. Jusuf 87.

Besimtari duhet të largohet nga kjo dhe të mos ketë mendim të keq ndaj Allahut. Sado që situatat janë të vështira, apo brengat e tij, apo sado që zgjatet sprovat, ai prapëseprapë duhet të ketë mendim të mirë ndaj Allahut, gjithnjë.

Si ka mundësi që besimtari të mos ketë mendim të mirë ndaj Tij kur në çdo namaz që fal këndon ajetin e sures Fatiha: **“të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit”**. Sa herë që dëshpërimi apo humbja e shpresës dëshiron ta mposhtë zemrën e besimtarit, kur e lexon këtë ajet, i largohet ky mendim i keq ndaj Allahut.

Si të mos ketë mendim të mirë ndaj Allahut kur e di se Mëshira e Tij ka përfshirë çdo gjë dhe e ka tejkaluar zemërimin e Tij. Allahu thotë: **“...mëshira Ime përfshin çdo gjë.”** Araf 156.

Si të mos ketë mendim të mirë ndaj Allahut kur e di se edhe dija e Tij ka përfshirë çdo gjë. Allahu tregon për lutjen të cilën ia drejtojnë engjëjt: **“Ti përfshin çdo gjë me mëshirën dhe dijeninë Tënde...”** Gafir 7. Ai e di çdo gjë. Ai e di kur njeriu është i sinqertë në pendimin e tij dhe ia pranon atë. Ai i di brengat, vështirësitë dhe shqetësimet e atyre që janë sprovuar me një sprovë apo fatkeqësi dhe ua largon ato, **“A ka më të mirë se Ai që i vjen në ndihmë nevojtarit të këputur, kur i lutet Atij, që jua largon të keqen...”** Neml 62. Ai i dëgjon lutjet e atyre që e lusin Atë për nevojat e tyre, **“Kur robërit e Mi (besimtarë) të pyesin për Mua, (thuaje se) Unë jam afër, i përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai më lutet Mua.”** Bekare 186. Ai i dëgjon lutjet e atyre të cilëve u është bërë padrejtësi dhe i ndihmon ata.

Si të mos ketë mendim të mirë ndaj Allahut kur e di hadithin kudsij në të cilin tregohet se Allahu ka thënë: **“Unë jam në mendimin robit Tim që e ka për Mua.”** Ashtu siç je ti në raport me Allahun me mendimet e tua, ashtu Ai do të jetë në raport me ty. Andaj, nëse ke mendim të mirë ndaj Allahut, edhe Ai do të jetë me ty dhe do të ndihmojë.

Rezultatet e mendimit të mirë ndaj Allahut:

- Allahu i përgjigjet lutjeve tona, i largon vështirësitë e brengat tona, i fal mëkatet tona, i pranon pendimet tona dhe na shpërblen për veprat e mira.
- Forcimi i mbështetjes tek Allahu.
- Stabiliteti, qetësia dhe lumturia e zemrës.
- Dëlrirja e zemrës prej humbjes së shpresës në Mëshirën e Allahut apo prej dëshpërimit ndaj ardhjes së ndihmës së Tij.

Përrulja në namaz

Përrulja gjatë faljes së namazit është prej veprave të zemrës, e cila ka pozitë shumë të lartë në fenë e Allahut. Domethënia e përruljes gjatë namazit: Zemra jote të qëndrojë me përrulje e nënshttrim para Allahut, e drejtuar komplet kah Ai.

Kur besimtari qëndron para Allahut në këtë mënyrë duke kujtuar madhësinë e Tij, se Ai është para tij dhe dëgjon atë që thotë, atëherë zemra e tij do të thyhet para Tij prej dashurisë dhe madhërimit që ka ndaj Tij. Kështu afrohet me Allahun dhe Ai afrohet me të. Ky lartësim i shpirtit dhe ky afrim me Allahun është në varësi të përruljes gjatë namazit. Në këtë mënyrë arrijn të forcojë lidhjen me Allahun, të shijojë ëmbëlsinë e namazit dhe të hyjë në portat e xhenetit të kësaj bote para se të hyjë në xhenetin e botës tjetër.

Përrulja është shpirti dhe jeta e namazit. Namazi pa përrulje është si një trup pa shpirt.

Rëndësia e përruljes gjatë faljes së namazit na sqarohet përmes këtyre pikave:

» *Përrulja gjatë namazit është rrugë për shpëtimin në botën tjetër. Allahu thotë: “Me të vërtetë, janë të shpëtuar besimtarët, të cilët janë të përrulur në namazin e tyre...”* Muminun 1-2.

» *Përrulja gjatë namazit është shkak për faljen e mëkateve. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: “Nuk ka ndonjë musliman i cili e fal namazin farz (kur të hyjë koha e tij), së pari duke marrë abdesin në mënyrën më të mirë, pastaj duke qenë i përrulur gjatë faljes dhe duke plotësuar rukunë e shtyllat e namazit, veçse ky namaz do të bëhet shlyerës i mëkateve të tij të kaluara (të vogla).”*

» *Përrulja gjatë namazit është shkak për forcimin e besimtarit kur goditet me sprova, fitne e fatkeqësi të ndryshme. Allahu thotë: “Kërkoni ndihmën e*

Allahut me durim e me namaz! Kjo është njëmend e vështirë, përveçse për të devotshmit, që janë të bindur se do të takojnë Zotin e tyre dhe se do të kthehen tek Ai." Bekare 45-46.

» Për aq sa besimtari është i përlurur e i vëmendshëm në namaz, për aq ka shpërblim. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **"Njeriu del prej namazit të tij dhe i shkruhet vetëm një e dhjeta si shpërblim, apo një e nënta, apo një e teta, apo një e shtata, apo një e gjashta, apo një e pesta, apo një e katërta, apo një e treta, apo një e dyta, apo gjysma."**

» Për aq sa besimtari është i përlurur gjatë namazit, aq do të përjetojë kënaqësinë e tij dhe qetësinë e zemrës. Allahu thotë: **"Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!"** Rad 28. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem I ka thënë Bilalit: **"Ngrihu të thërrasësh ezanin dhe na qetëso me namaz!"** Dhe: **"Mua më është bërë kënaqësia e syve (shpirtit dhe zemrës) në namaz."**

» Për aq sa besimtari është i përlurur gjatë namazit, aq do të ketë ndikim që të ndalet prej mëkateve dhe të shëmtuarave. Allahu thotë: **"Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar..."** Ankebut 45.

Shembuj të përluljes në namaz

Transmetohet nga Abdullah ibën Shekiri radijAllahu anhu: *"E kam parë Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem duke u falur një ditë dhe prej gjoksit të tij dëgjohej një gumëzhimë siç bën tenxherja kur vlon, kjo për shkak të së qarës gjatë faljes."*

Aisha radijAllahu anha ka treguar: *"Kur Pejgamberit salallahu alejhi ue selem iu vështirësua sëmundja (prej së cilës ka vdekur) i thanë që të dilte t'iu printe njerëzve në namaz, por ai tha: **"Urdhëroni Ebu Bekrin t'ua falë njerëzve namazin (të bëhet imam)!"** Vërtet Ebu Bekri është njeri i butë, kur lexon Kuran fillon të qajë."*

Alkame ibën ebi Vekasi ka treguar: *“Umeri radijAllahu anhu lexonte në namazin e Jacisë suren Jusuf. Unë kam qenë në safat e fundit dhe e kam dëgjuar të qarën e tij (gjatë këndimit të historisë së Jusufit).”*

Urve bin Zubejri ka thënë: *“E kam pyetur gjyshen time (Esman) se si ka qenë gjendja e sahabëve brenda namazit kur kanë dëgjuar Kuran dhe jashtë tij, dhe ajo ka thënë: “Sytë e tyre kanë rrjedhë lot dhe lëkurat e tyre janë rrëqethur.”*

Kjo ka qenë përrulja që ka pasur Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem dhe shokët e tij gjatë namazit. Këtë rrugë e kanë vazhduar edhe gjenerata pas tyre.

Madhështia e Kuranit Fisnik

Këtë temë më së miri do ta kuptojmë prej ngjarjes që i ka ndodhur Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem. Një ditë ai ka hyr në Qabe (derisa Qabja ka qenë nën sundimin e idhujtarëve) dhe aty ka qenë një numër i madh i prijësve të Mekës. Ai ka qëndruar pranë tyre dhe i ka befasuar duke lexuar suren Nexhm, në të cilën janë bashkuar madhështia e Kuranit dhe zëri i bukur i Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem. Ata nuk kishin dëgjuar fjalë më të mira e më të bukura. Për këtë, harruan mohimin e tyre dhe kryeneçësinë dhe dëgjonin me vëmendje këndimin e saj. Ai salAllahu alejhi ue selem vazhdoi të lexonte derisa arriti në ajetet e fundit të sures, të cilat ishin goditëse për zemrat e tyre. Këto ajete janë: **“Vallë, prej kësaj fjale po çuditëni dhe po qeshni e nuk po qani? Madje, jeni edhe të shkujdesur! Më mirë përuluni në sexhde për Allahun dhe adhurojeni Atë!”** Në këtë rast Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ra në sexhde dhe gjithashtu idhujtarët ranë në sexhde pas tij.

Ishte bukuria e fjalëve të Allahut që arrinte të thyente kokëfortësinë e idhujtarëve – njerëz arrogantë dhe kryelartë.

Disa çështje

-Arabët kanë letërsi dhe poezi të mrekullueshme, që tejkalojnë të gjitha letërsitë dhe poezitë botërore. Megjithatë, nuk mund të ketë krahasim mes letërsisë arabe dhe madhësisë së Fjalëve të Allahut.

-Fjalët e Allahut janë madhështore, sepse Kurani është i folur i Allahut – Cilësi e Tij. Allahu ka zbritur më parë Libra, në stilin më të lartë, në formulimin më madhështor dhe me shprehjet më të ëmbla, në secilën gjuhë që i ka shpallur ato. Pastaj ka ardhur Kurani i cili i ka shfuqizuar të gjitha ato Libra.

-Allahu ka thënë për Kuranin: **“Thuaj: “Ky (Kuran) është një mesazh i madh, e megjithatë ju nuk po ia vini veshin atij.”** Sad 67-68. Para tij janë përrulur edhe të zotët e gjuhës dhe askush nuk ka mundësi të sjellë qoftë dhe një sure të ngjashme me Kuranin. Velid ibën Mugire i cili ka qenë prej armiqve më të mëdhenj të Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem dhe kur ka dëgjuar Fjalët e Allahut: **“Në të vërtetë, Allahu urdhëron drejtësinë, mirësinë dhe ndihmën për të afërmit, si dhe ndalon imoralitetin, veprat e shëmtuara dhe dhunën. Ai ju këshillon, në mënyrë që ju t’ia vini veshin”**, ka thënë: *“Këto Fjalë e kanë një ëmbëlsi, shkëlqim dhe bukuri. Pjesa e poshtme e tyre është e pëlleshme, kurse pjesa e lartë jep frytë të vazhdueshme (si trupi i hurmës).”*

- Kurani madhështor përmban 114 sure. E para është Fatiha, të cilën Allahu e ka lartësuar. Allahu e ka përmendur në shumë ajete, prej tyre: **“Ne të kemi shpallur shtatë vargje që përsëriten dhe Kuranin e madhërishtëm.”** Hixhr 87. Pejgamberi salallahu alejhi ue selem ka thënë për të se ajo është surja më madhështore në Kuran, pastaj ka thënë: **“Ajo është shtatë ajete që përsëriten dhe Kurani madhështor që më është dhënë.”** Dijetarët thonë: *“I gjithë Kurani është i përmbledhur në suren Fatiha.”*

Ku jemi ne në raport me suren Fatiha? Sa po e përjetojmë dhe meditojmë atë? Suren Fatiha jemi urdhëruar ta lexojmë në çdo rekat të namazit, madje ajo është bërë shtyllë prej shtyllave të namazit, që nëse dikush e harron ta thotë në namaz qoftë nga harresa apo me qëllim, namazi i zhvlerësohet dhe duhet ta përsërisë. Ajo është ushqim për zemrën e besimtarit, i cili ka nevojë çdoherë për të. Duke qenë se ajo ka pozitë kaq të rëndësishme, atëherë besimtari patjetër duhet ta mësojë kuptimin e saj, të meditojë në të dhe të punojë me atë që e kërkon ajo.

Kur ne mësojmë kuptimet e sures Fatiha, kjo është prej shkaqeve të faljes së namazit me përrulje.

Dashuria dhe malli për Allahun

Malli për takimin me Allahun është prej veprave më madhështore të zemrës dhe niveleve të larta që besimtari i arrin në raport me Atë.

Ai që nuk e njeh bukurinë e Allahut, nuk do të qajë kurrë prej mallit për Atë. Pejgamberi salallahu alejhi ue selem ka thënë: **“Allahu është i Bukur dhe e do bukurinë.”** Ibën Kajimi kur flet rreth kësaj thotë: *“Prej llojeve më madhështore të njohjes së Allahut, është kur njeriu e njeh Atë përmes Bukurisë së Tij – Cilësi e Tij. Kjo njohje është për njerëzit e veçantë. Të gjithë e njohin Allahun përmes ndonjë Cilësie të Tij, por njohja më e plotë është kur e njeh përmes përsosmërisë, madhështisë dhe bukurisë së Tij. Ai është i lartësuar dhe Atij nuk i shëmbëllen asgjë në të gjitha Cilësitë e Tij.”* Dhe thotë: *“Allahu është i Bukur në Qenien e Tij, në Emrat e në Cilësitë e Tij dhe në Veprat e Tij.”*

Sa i takon bukurisë së Allahut në Qenien e Tij, kjo nuk mund të arrihet të njihet përveçse në Xhenet (kur besimtarët do ta shohin Atë me sytë e tyre). Es Sadi rahimehullah ka thënë: *“I Bukuri është Ai të Cilit i përkasin cilësitë e bukurisë dhe bamirësisë. Allahu është i Bukur në Qenien e Tij, në Emrat, në Cilësitë dhe në Veprat e Tij. Krijesat kurrë nuk kanë mundësi të përshkruajnë as dhe një pjesë të vogël të bukurisë së Qenies së Tij. Për këtë, banorët e xhenetit me gjithë përjetimet e kënaqësitë që kanë në xhenet, të cilat janë të përhershme, të mëdha, të papërshkrueshme, kur e shohin Allahun atëherë i harrojnë të gjitha ato dhe kënaqen duke parë bukurinë e Tij dhe dëshirojnë që kjo të zgjasë përherë. Ata kanë mall e dëshirë të madhe të shohin përsëri Allahun në radhën tjetër (në Ditën e Shtesës) dhe i gëzohen asaj dite, gati sa nuk u fluturojnë zemrat prej gëzimit.”*

Sa i takon bukurisë së Allahut në Emrat dhe Cilësitë e Tij, atëherë besimtarët këtë mund ta njohin qysh në jetën e kësaj bote, duke hedhur shikimin në Librin e Allahut – Kuranin dhe në sunetin e Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem dhe duke lexuar fjalët e dijetarëve (që flasin

për shpjegimin e Emrave, Cilësive dhe Veprave të Allahut). Dhe njeriu sa më shumë që e shton këtë dije, i shtohet edhe dashuria ndaj Allahut, e si rrjedhojë i shtohet dhe malli për takimin me Atë. Kjo sepse malli ndaj Allahut është rezultat i dashurisë ndaj Tij. Ibën Rexhebi ka thënë: *“Malli për Allahun është një gradë e ngritur e cila buron prej forcës së dashurisë ndaj Tij.”*

Pejgamberi salallahu alejhi ue selem është lutur: **“O Allah, kërkoj prej Teje të më mundësosh shikimin e kënaqësisë në Fytyrën Tënde dhe mallin për takimin me Ty!”**² Ahmedi.

Neve na merr malli për njerëzit që i duam dhe qajmë nga malli për takimin me ta. E ku janë zemrat tona në raport me mallin ndaj Allahut? A nuk themi se e duam Allahun më shumë se çdo gjë, ndërkohë që nuk kemi mall për takimin me Atë? Nga ana tjetër, përmallohemi për prindërit, bashkëshorten, fëmijët dhe vëllezërit. Nëse pretendojmë se e duam Allahun më shumë se këta, atëherë ku është malli jonë për takimin me Atë? Andaj, secili prej nesh, kur është duke e përmendur dhe kujtuar madhështinë dhe bukurinë e Allahut, patjetër se do t'i rrjedhin lotët prej mallit për Atë. Pejgamberi salallahu alejhi ue selem ka treguar se janë shtatë kategori të njerëzve të cilët Allahu do t'i strehojë në hijen e Arshit të Tij atë Ditë ku nuk ka hije tjetër, dhe prej tyre ka përmendur: **“Një person i cili e ka kujtuar Allahun në vetmi dhe prej syve të tij kanë rrjedhë lot.”** Imam Kurtubiu ka thënë: *“Rrjedhja e lotëve është në varësi të gjendjes së atij që e kujton dhe e përmend Allahun... Kur kujton Cilësitë që kanë të bëjnë me Madhështinë e Allahut, atëherë qan prej frikës ndaj Tij. Kur kujton Cilësitë që kanë të bëjnë me bukurinë e Allahut, atëherë qan prej mallit për takimin me Atë.”*

² Jo për shkak të sprovës e fatkeqësisë (siç veprojnë njerëzit e dunjasë), apo të ndonjë fitne në fe, por për shkak të dashurisë ndaj Allahut.

Malli për Allahun në jetën e kësaj bote: Kur ke mall të afrosh tek Ai, të përjetosh ëmbëlsinë e lutjeve dhe dhikreve, të gjesh prehje në adhurime. Kjo arrihet kur shpejton në kryerjen e adhurimeve të shumta prej dashurisë dhe mallit për Allahun.

Malli për takimin me Allahun në botën tjetër: Kur ke mall të shikosh Allahun në Xhenet dhe të dëgjosh Fjalët e Tij. Allahu thotë: **“Kush shpreson takimin e Allahut, ta dijë se Dita e caktuar nga Ai do të arrijë.”** Ankebut 5. Dijetarët kanë thënë: *“Ky ajet ka zbritur si ngushëllim e lehtësim për ata që kanë mall për Allahun.”* Kush ka mall për takimin me Atë, ta dijë se shumë shpejt do të vijë afati i caktuar (për të kaluar në botën tjetër dhe ta shohë Allahun në xhenet).

Nga shkaqet për arritjen e mallit për Allahun

- *Largimi i pengesave, që janë mëkatet (e epsheve dhe dyshimeve) dhe sëmundjet e zemrës. Këto gjëra e mbulojnë zemrën dhe e pengojnë njeriun në arritjen e mallit për takimin me Allahun. Mëkatet e pakësojnë dashurinë dhe mallin për Allahun.*
- *Mbushja e zemrës me dituri rreth Allahut, Emrave dhe Cilësive të Tij.*

Dashuria ndaj të Dërguarit salAllahu alejhi ue selem

Dashuria ndaj Allahut dhe ndaj të Dërguarit salAllahu alejhi ue selem është prej obligimeve kryesore të besimit dhe prej bazave të tij. Ajo është themel i çdo vepre që bëjmë në fenë tonë.

Dashuria ndaj të Dërguarit salAllahu alejhi ue selem është prej veprave më madhështore dhe më të larta të zemrës. Ai salallahu alejhi ue selem ka thënë: **“Askush nuk ka besuar derisa unë të jem më i dashuri për të sesa fëmijët e tij, prindërit e tij dhe të gjithë njerëzit.”**

Transmetohet se Umeri radijAllahu anhu i tha një ditë Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem: *“Ti je më i dashuri për mua se çdo gjë tjetër, përveç vetes sime.”* Atëherë ai salAllahu alejhi ue selem i tha: **“Jo pasha Atë në Dorën e të Cilit është shpirti im, derisa të jem unë më i dashuri për ty sesa vetja jote.”** Atëherë Umeri i tha: *“Po, prej tash ti je më i dashuri për mua sesa vetja ime.”*

Duhet t’ia parashtrojmë një pyetje vetes: *“Sa e duam Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem për ta takuar dhe shoqëruar në xhenet?”* Nga ana tjetër, ai salAllahu alejhi ue selem ka pasur mall për të na takuar neve. Transmetohet se u ka thënë sahabëve: **“Kam dëshirë të madhe t’i takoja vëllezërit e mi!”** Sahabët i kanë thënë: *“A nuk jemi ne vëllezërit e tu?”* Ai ka thënë: **“Ju jeni shokët e mi, porse unë kam dëshirë të takoja vëllezërit e mi të cilët ende nuk kanë ardhur (umetin e tij).”** Muslimi.

Kur ne e pasojmë Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem me të brendshmen dhe të jashtmen tonë, kjo është argument se e duam atë. Sa më shumë që e pasojmë, po aq e duam atë, dhe e kundërta.

Allahu thotë: *“Thuaju (o Muhamed): “Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua...”* Ali Imran 31.

Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Njeriu në botën tjetër do të jetë me atë që e ka dashur.”**

Mospasimi ndaj Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem bëhet në dy forma:

1. Me tejkalim të kufijve.
2. Me mangësi në pasim.

Njerëzit në raport me dashurinë ndaj Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem janë disa kategori:

» Ata që e kanë tepruar (kanë sjellë bidate në fe). Ata janë dy lloje: 1. Ata që kanë shpikur bidate, si: mewludi, nata 15-e muajit Shaban, dhikret e ndryshme, dhikret me kohë, forma e numra të caktuar etj. Këto bidate nuk nxjerrin nga feja, por nuk pranohen tek Allahu. 2. Ata që kanë shpikur bidate të cilat nxjerrin nga feja, si: lutja ndaj Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem, apo kërkimi i ndërmjetësimit prej tij, përshkrimi i tij me cilësi të cilat i takojnë vetëm Allahut).

» Ata që janë treguar të mangët. Ata janë dy lloje: 1. Ata që kanë refuzuar sunetin duke i dhënë përparësi mendjes apo inspirimeve të tyre apo opinioneve të njerëzve. 2. Ata që kanë qenë neglizhent duke vepruar mëkate.

» Ata që e ndjekin sunetin me të brendshmen dhe të jashtmen e tyre dhe nuk shpikin bidate, nuk e teprojnë në dashuri ndaj tij dhe nuk tregohen neglizhent.

Pirja prej burimit të Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem në botën tjetër, është e kushtëzuar me pasimin e sinqertë e të vërtetë të sunetit të tij, pa e ndryshuar atë. Jo çdokush prej muslimanëve do të pijë prej burimit të tij, për të cilin Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Nëse njeriu pi një herë prej tij, kurrë më nuk do ta kapë etja në pafundësi.”**

Gjithashtu ringjallja dhe tubimi me Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem në Ditën e gjykimit (të jesh nën flamurin e tij) kushtëzohet me pasimin e vërtetë të sunetit të tij.

Duhet të kemi kujdes nga neglizhenca në pasimin e sunetit dhe nga teprimi.

Allahu thotë: “**dhe shpirtrat të bashkohen**” Tekwir 7. Ibën Kethiri ka thënë: “Çdokush do t'i bashkohet grupit të tij. Kështu, nëse ke qenë pasues i vërtetë i Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem, do të jesh me grupin e tij.” Në të kundërt, do të jesh me ata që kanë shpikur bidate, apo e kanë ndryshuar sunetin profetik.

Frika ndaj Allahut

Frika ndaj Allahut është prej adhurimeve dhe veprave më të dobishme për zemrën. Ajo është njëra prej tri shtyllave të adhurimeve dhe njëri prej dy krahëve të zemrës gjatë shtegtimit për tek Allahu.

Frika ka dy nivele:

1. Frika ndaj dënimit të Allahut (hauf). Kjo ndodh te shumica e njerëzve. Allahu thotë: **“O njerëz, frikësojuni Zotit tuaj, sepse dridhja e Orës (së Kiametit), është vërtet një ngjarje e madhe! Ditën, që do të shihni atë, çdo grua me fëmijë në gji do ta harrojë fëmijën e saj dhe çdo grua shtatzënë do ta hedhë barrën e vet. Njerëzit do t’i shihni si të dehur, ndonëse ata nuk do të jenë të dehur, por dënimi i Allahut është i ashpër.”** Haxh 1-2. Dhe: **“Ata do të mbulohen me shtresa zjarri nga sipër dhe nga poshtë. Me këtë, Allahu i tremb robërit e Vet. “O robërit e Mi, më kini frikë Mua!”** Zumer 16. Dhe: **“Prandaj do t’u themi: “Shijojeni këtë! Ne nuk do t’ju shtojmë gjë tjetër përveçse dënim!”**³ Nebe 30.
2. Frika ndaj Allahut (hashje).⁴ Kjo ndodh te dijetarët, tek ata që e njohin Atë. Allahu thotë: **“Me të vërtetë, ata që dridhen nga frika e Zotit të tyre...”** Muminun 57. Dhe: **“Në të vërtetë, nga robërit e Tij, Allahut i frikësohen vetëm dijetarët...”** Fatir 28.

Sa herë që frika ndaj Allahut largohet prej zemrës, ajo do të shkatërrohet. E nëse ajo zë vend në zemër, atëherë do të djegë epshtet e vendosua në të dhe do të largojë prej saj favorizimin e kësaj bote ndaj botës tjetër.

³ Ky është ajeti më i ashpër që tregon për dënimin e madh të Allahut për banorët e zjarrit.

⁴ Kjo frikë shoqërohet me dijen rreth Allahut dhe Emrave e Cilësive të Tij.

Dobitë që përfitohen nga frika ndaj Allahut:

- Frika ndaj Allahut është prej gjërave që i kërkon besimi. Aq sa ke besim në zemër, për aq do t'i frikësohesh Allahut.
- Frika ndaj Allahut ndihmon të jesh i sinqertë në adhurimet dhe veprat e mira.
- Frika ndaj Allahut të nxit drejt veprimit të veprave të mira.
- Frika ndaj Allahut të largon prej mëkateve.
- Frika ndaj Allahut është prej shkaqeve që Allahu të të ruajë nga çdo e keqe.
- Frika ndaj Allahut është shkak për të ngadhënjyer kundër armikut.
- Frika ndaj Allahut është shkak për arritjen e sigurisë në botën tjetër.
- Frika ndaj Allahut është shkak që njeriu të jetë prej atyre që do të strehohen në hijen e Arshit të Allahut në Ditën e Gjykimit ku nuk do të ketë hije tjetër.
- Frika ndaj Allahut është shkak për arritjen e kënaqësisë së Allahut.
- Frika ndaj Allahut është shkak për të hyrë në Xhenet.

Disa prej shkaqeve që sjellin frikën ndaj Allahut në zemër: Të kujtosh madhësitinë dhe madhërinë e Allahut, të lexosh Kuran me meditim, të meditosh në hadithet profetike që flasin për madhësitinë e Allahut, të kesh frikë nga përfundimi i keq dhe nga mospranimi i veprave të mira, të kujtosh mëkatet e kaluara, të kujtosh vdekjen dhe jetën e varrit, të kujtosh Ditën e Gjykimit dhe ato që ndodhin atë Ditë dhe të kujtosh dënimin e xhehenemit.

Shpresa tek Allahu

Junusi alejhi ue selem gjendej brenda tri errësirave (errësira e natës, e detit dhe e barkut të balenës) dhe në vështirësi e brengë të madhe, megjithatë kurrë nuk e humbi shpresën tek Allahut, përkundrazi zemra e tij ishte e mbushur me shpresë tek Ai. Andaj e luti Allahun me shpresën që Ai ta çlironte nga kjo gjendje:

﴿لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ سُبْحَانَكَ إِنِّي كُنْتُ مِنَ الظَّالِمِينَ﴾

“Nuk ka të adhurar tjetër meritë përveç Teje. Ti je i lartësuar nga çdo e metë. Vërtet, unë i kam bërë keq vetes!”

Dhe menjëherë erdhi lehtësimi nga kjo gjendje e vështirë që kishte: **“Ne iu përgjigjëm atij dhe e shpëtuan nga brengosja. Kështu, Ne i shpëtojmë besimtarët.”** Enbija 88.

Ndërsa, Jakubi e kishte humbur djalin e tij Jusufin për vite me radhë, e pastaj edhe Benjaminin, e megjithatë kishte shpresë të madhe tek Allahu, **“O bijtë e mi, shkoni e kërkoni lajme për Jusufin dhe vëllain e tij dhe mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut. Shpresën në mëshirën e Allahut nuk e humb askush, përveç jobesimtarëve.”** Jusuf 87.

Shpresa tek Allahu është prej veprave madhështore të zemrës, ajo është njëra prej tre shtyllave të adhurimeve tona dhe njëri prej dy krahëve gjatë shtegtimit për tek Allahu. Kjo vepër e zemrës ka këtë pozitë kaq të lartë sepse buron nga dija dhe dituria rreth Emrave, Cilësive dhe veprave të Allahut. Forca e shpresës te Allahu është varësisht dijes dhe njohurive që personi ka ndaj Allahut dhe ndaj Emrave e Cilësive të Tij, po ashtu varësisht njohurive që ka ndaj Mëshirës së Tij (e cila ka triumfuar zemërimin e Tij).

Të kesh shpresë tek Allahu do të thotë:

-vazhdimisht të shpresosh e ta përgëzosh veten për mirësitë dhe bujarinë e Allahut, dhe kështu zemra qetësohet.

-të jesh i bindur se do të arrijnë tek ti mirësia dhe bujaria e Allahut.

Disa pika që tregojnë për rëndësinë e shpresës tek Allahu:

- Shpresa tek Allahu është shenjë për besimin tënd dhe e kundërta. Varësisht besimit që ke, do të jetë edhe shpresa tek Ai.
- Shpresa tek Allahu është shkak ta duash Atë.
- Shpresa tek Allahu nxit në shtimin e veprave të mira (sepse shpreson për t'u shpërblyer në të dy botët).
- Shpresa tek Allahu nxit në pendim dhe kthim tek Ai sinqerisht (sepse kur e di se Ai t'i falë mëkatet atëherë do të pendohesh).
- Shpresa tek Allahu është shkak për lehtësimin e vështirësive dhe brengave dhe për faljen e gjynaheve.
- Shpresa tek Allahu është shkak për afrimin tek Allahu dhe lidhjen e fortë me Atë.
- Shpresa tek Allahu është shkak për zgjerimin e gjoksit dhe qetësimin e zemrës. Një njeri të tillë nuk e luhatin brengat, shqetësimet e pikëllimit e shumta dhe nuk e dobësojnë sprovat që e godasin.
- Shpresa tek Allahu është shkak për t'iu përmbajtur rrugës së mesme, sepse shpresa e balancon frikën ndaj Allahut, dhe kështu besimtari nuk anon nga njëra anë, por ndjek të mesmen. Ai që ka vetëm shpresë në zemër, atëherë do të braktisë veprat e mira dhe do të shpresojë tek Allahu pa vepruar (kjo gjë është gabim). Ai që ka vetëm frikë në zemër, atëherë do të humbasë shpresën tek Ai. Andaj, duhet patjetër të kesh shpresë dhe frikë (të balancuar).

Disa ajete që tregojnë për këtë adhurim të zemrës janë:

-“ju shpresoni prej Allahut atë që ata nuk e shpresojnë.” Nisa 104.

-“Vërtet, ata që besuan dhe ata që mërguan e luftuan në rrugë të Allahut, pikërisht ata shpresojnë në mëshirën e Allahut.” Bekare 218.

-“Vetë ata që idhujtarët u luten, kërkojnë t’i afrohen Zotit të tyre, madje edhe më të afërtit, duke shpresuar mëshirën e Tij dhe duke iu frikësuar dënimit të Tij.” Isra 57.

-“Kur Allahu i krijoi krijesat, shkroi në një Libër i cili është tek Ai, mbi arsh: “Mëshira Ime triumfon mbi zemërimin Tim!” Hadith.

-“Allahu është më i mëshirshëm sesa kjo nënë për fëmijën e saj.” Hadith.

-“Kur dikush prej jush praktikon Islamin në formën më të mirë, atëherë për çdo të mirë që kryen shpërblehet dhjetëfish deri në shtatëqindfish, ndërsa për çdo të keqe i shkruhet një e keqe.” Hadith.

-“Allahu e shtrin dorën e Tij gjatë natës që të pendohet ai që ka bërë mëkate gjatë natës dhe shtrin dorën e Tij gjatë ditës që të pendohet ai që ka bërë mëkate gjatë ditës, kjo derisa të lindë dielli nga perëndimi.” Hadith.

-“Allahu ka 100 mëshira, një prej tyre e ka zbritur në mesin e krijesave dhe përmes saj mëshirojnë njëri-tjetrin, madje dhe egërsira e mëshiron të voglin e saj, ndërsa 99 mëshira i ka lënë për Ditën e Gjykimit (me të cilat do t’i mëshirojë robërit e Tij atë Ditë).” Hadith.

-“E drejta e njerëzve ndaj Allahut është që të mos i dënojnë ata që nuk i bëjnë shirk Atij.” Hadith.

Disa dobi që përfitohen nga shpresa tek Allahu:

- Përmes shpresës tek Allahu shfaqim nevojën për Atë në çdo gjë.
- Allahu dëshiron që njerëzit të shpresojnë tek Ai.

- Ajo nxit dhe inkurajon njeriun përgjatë rrugëtimit për tek Allahu.
- Ajo dërgon në dashurinë ndaj Allahut dhe kënaqjen me Atë.
- Ajo dërgon në nivelet më të larta të besimit, që është niveli i falënderimit ndaj Allahut.
- Ajo nxit në shtimin e diturisë rreth Allahut dhe Emrave dhe Cilësive të Tij.
- Personi që ka shpresë tek Allahu është në pritje të të mirave të Tij, dhe kjo e bën të jetë i lidhur me Atë, të bëjë dhikër, të kthehet me zemër tek Ai dhe të shohë gjurmët e Emrave dhe Cilësive të Tij në këtë univers.

Çështje: Ai që është neglizhent në raport me Allahun dhe bën mëkate e pastaj kthehet me pendim tek Ai dhe kërkon falje, duhet të shpresojë tek Allahu se Ai se do ta falë atë. Po ashtu, ai që kryen vepra të mira dhe e adhuron Allahun, duhet të shpresojë se Ai do ta shpërblejë në këtë botë dhe tjetrën. Ndërsa, ai që bën mëkate e gabime të ndryshme, dhe pastaj shpreson mëshirën e Allahut, ky është mashtrim i shejtanit, ngase Allahu ka thënë: **“...kush shpreson takimin me Zotin e vet, le të bëjë vepra të mira dhe të mos i shoqërojë askënd në adhurim Zotit të vet!”** Kehf 110. Së bashku me shpresën tek Ai, na urdhëron të veprojmë vepra të mira.

Madhërimi ndaj Allahut të Plotfuqishëm

Madhërimi ndaj Allahut është prej veprave më të rëndësishme dhe më madhështore të zemrës. E sidomos sot muslimani e ka detyrë ta realizojë këtë adhurim në zemrën e tij, ta zbatojë dhe të thërrasë në të, ngase njerëzit kanë filluar ta kundërshtojnë madhërimin ndaj Allahut përmes disa mënyrave:

-Bërjes së mëkateve, saqë disave kjo u është bërë zakon (siç shohim disa popuj).

-Nënvlerësimin, nënçmimin e talljes me simbolet e Islamit dhe praktikuesit.

-Mosmadhërimi të teksteve të Kuranit e sunetit duke i dhënë përparësi mendimeve/opinioneve të veta (siç ndodh tek sektet e humbura, apo hipokritët etj.).

Realiteti i madhërimit ndaj Allahut

Këtë na sqaron më së miri dijetari es Sadi rahimehullah: *“Kuptimet e pohuara dhe të vërtetuara të madhërimit të Allahut janë dy lloje: 1. Ai është i cilësuar me çdo Cilësi që tregon përsosmërinë e Tij. 2. Askush prej njerëzve nuk meriton të madhërohet si Allahu. Ai e meriton të madhërohet prej robërve të Tij me zemër, me gjuhë dhe me gjymtyrë. Kjo arrihet kur ata përpiqen shumë ta njohin Allahun, ta duan, t’i nënshtrohen dhe t’i përulen Atij, si dhe ta lavdërojnë me gjuhë dhe të veprojnë me gjymtyrë në mirënjohje/falënderim ndaj Tij...”*

Madhërimi dhe dashuria ndaj Allahut është shpirti i adhurimit që bëjmë. Aq sa njeriu ka dije për Allahun, për Emrat, Cilësitë dhe veprat e Tij, aq do të ketë madhërim ndaj Tij në zemrën. Ai që e njeh Allahun më së shumti, është ai i cili e madhëron Atë më së shumti.

Rëndësia e madhërimit ndaj Allahut:

- Njësimi i Allahut në uluhije, rububije dhe në emrat e cilësitë e Tij, bazohet e ndërtohet mbi madhërimin ndaj Allahut.
- Njerëzit do të dallojnë varësisht besimit, madhërimit ndaj Allahut me zemrat e tyre dhe bindjes se janë nën mbikëqyrjen e Tij (fshehtas dhe në publik).
- Madhërimi ndaj Allahut është themeli mbi të cilin ngritën dhe ndërtohen shumë vepra të zemrës, në të cilat bazohet të qenët rob adhures ndaj Allahut, si: dashuria, frika, shpresa, turpi, sinqeriteti, bindja etj.
- Madhërimi ndaj Allahut bëhet shkak që njeriu të shpejtojë të kryejë adhurime dhe vepra të mira.
- Nëse madhërimi ndaj Allahut zë vend në zemrën e personit, atëherë kjo bëhet shkak që ai të respektojë ndalesat e Tij (të mos i shkelë ato). E nëse ndodh të bie në ndalesa, atëherë për shkak të madhërimit që ka ndaj Allahut, do të shpejtojë në pendim dhe kthim tek Ai dhe do të kërkojë falje. Ibën Kajimi ka thënë: *“Për personin i cili kryen mëkate, mjafton si dënim dobësimi i madhërimit ndaj Allahut në zemrën e tij.”*
- Nëse madhërimi ndaj Allahut zë vend në zemrën e personit, kjo është prej shkaqeve të ruajtjes së zemrës prej dyshimeve.
- Nëse madhërimi ndaj Allahut zë vend në zemrën e personit, kjo është shkak që ai të jetë i përvuilur në namazin e tij.

Disa prej ajeteve që flasin për madhërimin ndaj Allahut:

-“Ata nuk e madhëruan Allahun siç e meriton të madhërohet. Në Ditën e Kiametit, e tërë Toka do të jetë në grushtin e Tij, ndërsa qiejt do të mbështillen nën të djathtën e Tij. Qoftë i lavdëruar Ai dhe i lartësuar mbi idhujt që ia shoqërojnë Atij (në adhurim)!” Zumer 67.

Dhe: **“O njerëz, është sjellë një shembull, andaj dëgjojeni atë: “Idhujt që ju i adhuron në vend të Allahut, nuk mund të krijojnë as edhe një mizë, edhe nëse bashkohen të gjithë për këtë. E, nëse miza u merr atyre diçka, ata nuk do të mund t’ia marrin. I dobët është përgjëruesi (adhuruesi), por edhe ai të cilit i përgjërohen (idhulli).” Ata nuk e çmojnë Allahun me vlerën e Tij të vërtetë. Vërtet, Allahu është i Fortë dhe i Plotfuqishëm.”** Haxh 73-74. Dhe: **“Ata nuk madhërojnë siç duhet Allahun, kur thonë: “Allahu nuk i ka zbritur asgjë njeriut”** Enam 91.

Shejkhul Islam ibën Tejmije kur flet për këto ajete thotë: *“Te ajeti i parë, Allahu pohon madhërinë e cila është në Qenien e Tij dhe Cilësitë që i meriton. Tek ajeti i dytë, Allahu pohon teuhidin dhe se vetëm Allahu është Ai i Cili e meriton adhurimin. Tek ajeti i tretë, Allahu pohon se Ai ka zbritur Shpallje te Pejgamberët e Tij. Tek të tre ajetet, Allahu i nënçmon ata (jobesimtarët, idhujtarët) që nuk e kanë madhëruar ashtu siç Ai e meriton. Ky është argument se besimtari e ka obligim ta madhërojë Allahun ashtu siç e meriton Ai, ta ketë frikë Atë dhe ta kundërshtojë nefsën e tij.”*

“Qiejt gati sa nuk copëtohen prej kësaj; Toka gati sa s’çahet e malet sa s’rrëzohen të thërrmuar, ngaqë ata i veshin një bir të Gjithëmëshirshmit.” Merjem 90-91. Ibën Kethiri ka thënë: *“Për shkak të madhërimit që kanë ndaj Allahut.”*

Shejh AbdulUehab rahimehullah ka thënë: *“Ato që na janë përmendur nëpër tekstet fetare për madhësitinë e Allahut, janë vetëm aq sa e perceptojnë mendjet tona. Madhështia dhe madhëria e Allahut është shumë më e gjerë dhe më e madhe se aq, saqë mendjet tona kurrë nuk mund ta perceptojnë atë.”*

Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: *“Kur Allahu dëshiron të shpallë diçka, Ai flet me të dhe të gjithë universin e kap një dridhje e madhe prej frikës ndaj Tij. Kur e dëgjojnë engjëjt, alivanosen dhe i bien në sexhde*

Allahut. I pari që e ngreh kokën është Xhibrili. Dhe Allahu i flet nga ajo që dëshiron prej shpalljes.”

Rezultatet që sjellë madhërimi ndaj Allahut te personi:

» Dashuria ndaj Allahut. Ata që i nënshtrohen dhe e madhërojnë Allahun, do ta duan Atë.

» Atë që e madhëron Allahun, do ta duan krijesat dhe do të jetë i pranuar tek ta.

» Përmes madhërimit ndaj Allahut arrihet qetësia dhe prehja, kjo sepse ai që e madhëron Allahun ka zemër të lidhur për Atë, ka mendim të mirë ndaj Tij dhe çështjet ia dorëzon Atij.

» Ai që e madhëron Allahun, ka ëmbëlsi të besimit në zemrën e tij dhe ka lumturi në gjoksin e tij (kjo sepse ka zbatuar urdhrat e Tij dhe është larguar prej ndalesave).

» Allahu zbret mëshirë mbi ata që e madhërojnë Atë. Dhe kështu ua largon brengat, ua lehtëson vështirësitë, iu përgjigjet lutjeve të tyre dhe iu ndihmon kundër armiqve të tyre.

» Allahu e fut në xhenet atë që e madhëron Atë.

Shkaqe të cilat ndihmojnë të kemi madhërim ndaj Allahut: Të meditojmë mbi kuptimet e ajeteve të Kuranit, të pajisemi me dije rreth Emrave e Cilësive të Tij si dhe gjurmëve të tyre tek krijesat, të lutemi tek Allahu të na mbushë zemrën me madhërimin ndaj Tij, të shtojmë dhikrin, të kryejmë adhurimet me përpulje e nënshtrim, të shoqërohemi me të devotshmit dhe t’ia kujtojmë vetes dhe të tjerëve madhërimin ndaj Allahut.

Nevoja e njeriut për Allahun

Musa alejhi ue selem pasi largoi një gur të madh prej një pusi të cilin nuk mund ta largonin vetëmse një grup i madh i burrave të fuqishëm, shkoi të strehohej në një hije të pemës dhe filloi t'i dobësohej forca, dhe iu lut Allahut me zemër të përrulur, duke shfaqur nevojën për Atë: **“Zoti im, çfarëdo dhuntie që të më japësh, unë jam nevojtar!”** Kasas 24.

Dhe pas kësaj Allahu sjelli lehtësimin për Musën: **“Menjëherë, njëra nga ato dyja, erdhi me ndrojtje dhe i tha: “Babai im të fton për të të shpërblyer, se i dhe ujë (tufës sonë)”**. Kur Musai shkoi tek ai dhe i tregoi çfarë kishte përjetuar, ai tha: **“Mos u frikëso, sepse ke shpëtuar prej një populli keqbërës!”** **“O babai im, - tha njëra nga ato të dyja - merre këtë njeri në shërbim! Sigurisht që njerëzit e fortë dhe të besueshëm janë më të mirët, që dikush mund të marrë në shërbim”**. Plaku tha: **“Unë dua të të jap për grua njëren prej këtyre dy bijave të mia, me kusht që të më shërbesh mua tetë vjet; por, nëse dëshiron, mund të qëndrosh dhjetë vjet. Unë nuk dëshiroj të t'i rëndoje gjërat. Ti do të shohësh, në dashtë Allahu, se jam një njeri i mirë.”** Kasas 25-26.

Musës i erdhi furnizimi, siguria, strehimi dhe mundësia për t'u martuar.

Nevoja për Allahun është prej adhurimeve dhe veprave më madhështore të zemrës. Ajo ka pozitë të lartë tek Allahu, ngase është prej adhurimeve që i japin shpirt e jetë adhurimeve të jashtme dhe të brendshme. Ato nuk kanë shpirt nëse gjatë tyre nuk e shfaqim nevojën tonë për Allahun. Ibën Kajim ka thënë: *“Nevoja për Allahun është realiteti dhe esenca e adhurimit (të qenët rob adhurues ndaj Allahut).”*

Andaj:

▪Njeriu nuk ka mundësi të realizojë kuptimet e ubudijes përderisa nuk

realizon kuptimet e nevojës për Allahun me të brendshmen dhe të jashtmen e tij.

▪Nevoja për Allahun është shpirti i të gjitha llojeve të adhurimeve të bëjmë.

Përkufizimi këtij adhurimi: *“Nevoja e vërtetë për Allahun është kur njeriu vazhdimisht e shfaq këtë gjë plotësisht në çdo gjendje të tij dhe në çdo qelizë të tij. Kjo nevojë është në natyrën e njeriut (është krijuar i atillë prej Allahut).”*

Të kesh nevojë për Allahun është që ti si rob i Tij ta shohësh (me sytë e zemrës) dhe të përjetosh nevojën e domosdoshme për Allahun dhe të dish se nuk ka ndryshim veçse me ndihmën e Tij. Edhe lëvizja dhe ndryshimi më i vogël ndodh vetëm me ndihmën e Tij. Kjo ndjesi duhet të na shoqërojë në çdo çast të jetës sonë dhe në të gjitha çështjet (të fesë dhe të dunjasë).

Rëndësia e këtij adhurimi:

» Nevoja për Allahun është thelbi dhe esenca e adhurimeve tona. Për aq sa posedon nga ky adhurim në zemrën tënde, aq do të ngrihesh dhe lartësohesh në nivelet e të qenët rob i Allahut.

» Kur ti e ndjen dhe e përjeton se je nevojtar për Allahun në të gjitha çështjet e tua, kjo është shkak të jesh i thjesht e modest ndaj Tij dhe të të largohet prej teje mendjemadhësia dhe vetëmjaftueshmëria.

» Ky adhurim bën që zemra jote të jetë e lidhur vetëm për Allahun dhe t’i mbështetesh Atij.

» Ky adhurim bëhet shkak që t’i nënshtrohesh Allahut e ta lusësh vetëm Atë.

» Ky adhurim bëhet shkak që të afrohesh më shumë me Allahun dhe të gësh prehje e kënaqësi kur e adhuron dhe e lut Atë.

» Ky adhurim bëhet shkak që të shtosh adhurimet.

» Ky adhurim bëhet shkak që të largohesh prej mëkateve, e nëse ndonjëherë bie në to, atëherë menjëherë do të shpejtosh të pendohesh e të kërkosh falje.

» Ky adhurim bëhet shkak që ta duash Allahun. Kur sheh se je nevojtar për Allahun dhe se Ai të ka dhënë mirësi të shumta, sa shumë të ka nderuar, sa bujari të madhe ka shfaqur ndaj teje dhe çfarë kujdesi të madh të ka bërë, atëherë patjetër do ta duash Atë.

» Ky adhurim bëhet shkak që Allahu të të dojë. Zemrat që e ndjejnë dhe e shfaqin nevojën për Allahun dhe janë të përlura e të thyera para Tij, janë zemrat më të dashura tek Ai.

Disa ajete që tregojnë për nevojën e njeriut për Allahun:

-“O njerëz! Ju jeni të varfër e nevojtarë për Allahun, kurse Allahu s’ka nevojë për asgjë dhe është i Denjë për çdo lavd.” Fatir 15.

-“Zoti im, çfarëdo dhuntie që të më japësh, unë jam nevojtar!” Kasas 24.

-“Çdo mirësi që keni, është nga Allahu.” Nahl 53.

-“Atij i lutet gjithkush që ndodhet në qiej dhe në Tokë e në çdo kohë Ai ushtron fuqinë e gjithëmbarshme.” Rrahman 29.

-“O Allah, Zotëruesi i gjithë Pushtetit! Ti ia jep pushtetin kujt të duash dhe ia heq kujt të duash; Ti lartëson kë të duash dhe poshtëron kë të duash. Çdo e mirë është në Dorën Tënde! Ti je vërtet i Plotfuqishëm për çdo gjë.” Ali Imran 26.

-Hadith kujdsij: **“O robërit e Mi! Të gjithë ju jeni në humbje përveç atij që e kam udhëzuar, andaj kërkoheni këtë prej Meje dhe Unë ju udhëzoj! O robërit e Mi! Të gjithë ju jeni të uritur përveç atij që i jap ushqim, andaj kërkoheni këtë prej Meje dhe Unë do t’ju ushqej! O robërit e Mi! Të gjithë ju jeni të zhveshur përveç atij që i kam dhënë**

(rroba) të vishet, andaj kërkoheni këtë prej Meje dhe Unë do t'ju vesh!" Ky hadith na tregon për gjëra të cilat nuk na shkon ndërmend se jemi nevojtarë për Allahun, si: ushqimi i përditshëm, rrobat që veshim, e më e rëndësishmja udhëzimi. Ne jemi nevojtarë që Allahu të na forcojë gjithnjë në fenë e Tij.

-Beshir ibn Harith: *"Pozita më e lartë është kur njeriu beson bindshëm se ka nevojë për Allahun deri në vdekje."* Ebu Hafsa: *"Vepra më e mirë me të cilën njeriu kërkon afim tek Allahu është kur e ka ndjesinë se është nevojtar për Allahun vazhdimisht në çdo gjendje, e pason sunetin në të gjitha veprat e tij dhe furnizimin e kërkon prej Krijuesit të tij."*

Realizimi i këtij adhurimi arrihet përmes dy gjërave, siç tregon ky ajet: **"O njerëz! Ju jeni të varfër e nevojtarë për Allahun, kurse Allahu s'ka nevojë për asgjë dhe është i Denjë për çdo lavd."** Fatir 15. E para: Të dish madhësinë dhe madhërinë e Allahut, se Ai është i vetëmjaftueshëm, i panevojshëm për robërit e Tij absolutisht. E dyta: të dish dobësinë tënde si krijesë, pa përsosmërinë tënde, nevojën tënde dhe varfërinë tënde ndaj Allahut, se ti nuk zotëron asgjë për vetën tënde.

Shenjat që tregojnë se ne e posedojmë këtë adhurim në zemrat tona:

1. Nënshtrimi e përrulja ndaj Allahut dhe dashuria ndaj Tij.
2. Lidhja e zemrës me Allahun dhe me gjërat që i do Ai.
3. Dhikri i vazhdueshëm dhe istigfari.
4. Frika për mospranimin e veprave të mira.
5. Frika ndaj Allahut në fshehtësi (larg syve të njerëzve) dhe në publik.
6. Respektimi e madhërimi i urdhrave (i zbatojmë) dhe ndalesave të Allahut (nuk i veprojmë).
7. Shpejtimi në pendim pas mëkatit.

Përrulja ndaj Allahut

Përrulja dhe nënshtrimi ndaj Allahut është gjithashtu prej adhurimeve më madhështore dhe më të rëndësishme të zemrës. Për këtë arsye ka pozitë të lartë dhe gratë të ngritur në fe.

Ky adhurim është përmendur në shumë ajete kuranore, mirëpo duke iu referuar tri gjërave shumë të rëndësishme në jetën e besimtarit:

1. *(Të bëhet) Gjatë lutjes, “**Lutjuni Zotit tuaj përrulshëm dhe ngadalë!**”* Araf 55. Lutësi, i cili ende nuk ka marrë përgjigje dhe nuk i është larguar brenga që ka pasur, atëherë le t'i kthehet vetes se ndoshta nuk ka qenë i sinqertë në përruljen ndaj Allahut gjatë lutjes së tij.
2. *Gjatë dhikrit, “**Përrmende Zotin tënd me vete, i përrulur dhe me frikë - jo me zë të lartë**”* Araf 205. Përrulja ndaj Allahut dhe thyerja para Tij gjatë bërjes së dhikrit, është prej shkaqeve të shijimit të ëmbëlsisë dhe kënaqësisë së besimit dhe dhikrit. Nëse nuk e ndjen këtë ëmbëlsi të dhikrit atëherë ka mundësi se nuk ke përrulje të sinqertë ndaj Allahut gjatë bërjes së dhikrit.
3. *Gjatë fatkeqësive, sprovave, “**Ne iu kemi dërrguar shumë popujve profetë para teje dhe i kemi dërrnuar ata me skamje dhe fatkeqësi, për t’u bërë të dërrgjueshëm. Vetëm sikur të përruleshin kur u erdhi ndëshkimi Ynë! Por zemrat e tyre u bënë gur, ndërrsa djalli ua paraqiste si të bukura veprat e tyre të këqija.**”* Enam 42-43. *“**Ne i dërrnuam ata njëherë, por ata nuk iu përrulën Zotit të tyre e as nuk i drejtuan lutje.**”* Muminun 76. Pendimi prej gjynaheve dhe kthimi tek Allahu me përrulje dhe nënshtrim, është prej shkaqeve kryesore për t’u mbrojtur prej zemërimit të Allahut dhe për largimin e fatkeqësive dhe sprovave para apo pasi të ndodhin.

Dobitë e përuljes ndaj Allahut:

- Ajo është dera më e gjerë dhe më e afërt që afron te dashuria ndaj Allahut dhe që të të dojë Allahu. Ibën Kajimi ka thënë: *“Nënshtimi dhe përulja ndaj Allahut mbjell dashurinë ndaj Tij...”*
- Allahu është më së afërmi me ata zemrat e të cilëve janë të nënshtuara e të përulura, gjatë lutjeve dhe dhikrit.
- Ajo është shpirti i lutjeve dhe dhikreve që bëjmë.
- Ajo është prej shkaqeve kryesore që lutja të marrë përgjigje, që Allahu të ta shtojë furnizimin, të të ndihmojë, të t'i largojë brengat dhe të t'i falë gjynahet.
- Ajo është prej shkaqeve që mbrojnë prej dënimit dhe ndëshkimit të Allahut.
- Ajo është prej shkaqeve përmes të cilave arrihet lumturia në botën tjetër.

Shkaqet që ndihmojnë të jemi të përulur ndaj Allahut janë:

- » Shtimi i dijes rreth Emrave dhe Cilësive të Allahut.
- » Hedhja sy të metave tua (njeriu është i mangët dhe nevojtar për Allahun).
- » Pastrimi i zemrave prej sëmundjeve të saj, si: mendjemadhësia, mburrja, kryelartësia etj. Ato kundërshtojnë përuljen ndaj Allahut.
- » Zbutja e zemrës dhe largimi nga shkaqet që e ngurtësojnë atë.
- » Marrja mësim e këshillë (reflektimi) prej gjërave që ndodhin përreth.
- » Pasja kujdes ndaj pasuesve të epshit, dyshimeve, bidateve dhe rrugëve të humbura.

» Mosanimi kah dunjaja dhe bukuritë e saj dhe pasja kujdes ndaj atyre që janë sprovuar me të.

» Shoqërimi me njerëz të devotshëm.

» Leximi i historive të Pejgamberëve dhe njerëzve të devotshëm (marrja shembull ata).

» Lutja drejtuar Allahut të të japë zemër të përulur ndaj Tij.

» Leximi i Kuranit me përulje e meditim.

» Dëgjimi i Kuranit nga ata që e këndojnë me zë të bukur dhe me përulje.

Këtu përfundon kjo temë – veprat e zemrës, e cila është kaq madhështore. Besimtari ka nevojë për këto gjëra gjatë tërë jetës së tij.

(Këto transkriptime nuk janë të kontrolluara nga hoxha)